



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 02.11.2022

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2023”

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjet e zhvilluara në datat **31.10.2022, 01.11.2022 dhe 02.11.2022** ne cilësinë e Komisionit *që jep mendim* mori në shqyrtim Projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2023” në parim.

Në mbledhjet e Komisionit për paraqitjen e projektligjit mori pjesë Ministria për Ekonominë dhe Financat, e përfaqësuar nga Znj. Adela Xhemali, Zv. Ministre si dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, e përfaqësuar nga Znj. Artemis Dralo, Zv. Ministre, Ministria e Shtetit dhe Kryenegociatorja, Znj. Majlinda Dhuka, si dhe Agjensia e Shtetërore të programimit strategjik dhe koordinimit të ndihmës, e përfaqësuar nga Z. Ilir Beqaj. Drejtor.

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2023” parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore (buxheti i shtetit) e vendore (buxheti vendor) dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve) për vitin buxhetor 2023.

Projektbuxheti i vitit 2023 vijon të mbështesë rritjen ekonomike të vendit pavarësisht efekteve negative të dy fatkeqësive natyrore si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19 si dhe të konfliktit Rusi – Ukrainë në fillimin e vitit 2022. Njëkohësisht, nëpërmjet politikës së konsolidimit fiskal synohet të sigurohet një ulje e qëndrueshme e stokut të borxhit publik në periudhën afatmesme 2023-2025. Projektbuxheti 2023 gjithashtu synon qëndrueshmërinë fiskale, e cila siguron qëndrueshmëri të financave publike shqiptare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, duke krijuar baza të forta për një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Në projektbuxhetin e vitit 2023, **programimi i të ardhurave buxhetore** mbështet synimet e Qeverisë për rritje ekonomike të qëndrueshme, si dhe uljen e vazhdueshme të defiçitit buxhetor dhe stokut të borxhit publik. Ky programim bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rritjen ekonomike, si dhe duke nxitur prodhimin dhe eksportet. **Shpenzimet buxhetore për periudhën 2023-2025** do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike, duke u përqendruar në financimin e projekteve me rëndësi strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë synojnë mbështetjen për dixhitalizimin dhe sigurinë kibernetike, finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale,

sigurinë kombëtare, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në kuadër të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, në vitin 2023 do të vijojë adresimi i çështjeve të lidhura me barazinë gjinore kryesisht në fushat e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik. **Projektbuxheti për vitin 2023 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për jetësimin e reformës në drejtësi**, përmes funksionalizimit të organeve të reja të drejtësisë si dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe miratimit të akteve nënligjore për zbatimin e reformës në drejtësi. **Shpenzimet e personelit për vitin 2023**, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, si dhe politikën e re të rritjes së pagave për sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes (nisur në 1 korrik 2022) si dhe rritjen e pagave për administratën publike (nisur në 1 shtator 2022) me mesatarisht 7%. Fondi vjetor për rritjen e pagave është planifikuar në shumën 2.3 miliardë lekë dhe parashikon rritjen e pagës për funksion me 6% për punonjësit e sistemit shëndetësor dhe ata arsimorë. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike janë planifikuar në masën 96.8 miliardë lekë ose 4.5% e PBB.

Në planifikimin e investimeve publike për vitin 2023 janë mbajtur gjithashtu në konsideratë prioritetet e integritit europian dhe të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Edhe në vitin 2023 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim.

Vazhdon të mbetet prioritet i Qeverisë Shqiptare për vitin 2023 avancimi i negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, pas hapjes së tyre me 19 korrik 2022 pas mbajtjes së Konferencës së parë Ndërqeveritare dhe gjithashtu avancimi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit BE-Shqipëri me fokus në dialogun politik dhe çështjet rajonale, iniciativat dhe bashkëpunimin rajonal.

1. Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2022-2024

Ky projektligj nuk është i parashikuar në PKIE 2022-2024, sepse kjo fushë nuk është e harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ajo mbetet kompetencë e vetë Shteteve Anëtare të BE-së.

2. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor

Legjislacioni parësor i BE-së:

Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Pjesa e Gjashtë “Dispozita Institucionale dhe Financiare”, Titulli II “Dispozita Financiare”, Kreu 3 “Buxheti Vjetor i Bashkimit Europian”, Nenet 313-316; Kreu 5 “Dispozita të Përbashkëta”, nenet 320-324.

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 18 Korrik 2018 “Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr.1296/2013, (BE) Nr.1301/2013,

(BE) Nr.1303/2013, (BE) Nr.1304/2013, (BE) Nr.1309/2013, (BE) Nr.1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, BE Nr.283/2014 dhe Vendimin Nr. 541/2014/BE dhe shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom), Nr 966/2012”.

Legjislacioni parësor (Nenet 313-316 dhe 320-324 të TFBE-së) dhe dytësor i BE-së (Rregullorja (BE), Nr.2018/1046), përmban vetëm rregullat lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të Bashkimit European, por nuk parashikon rregulla lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së. Për pasojë, hartimi dhe miratimin i buxhetit nga Shtetet Anëtare të BE-së është kompetencë ekskluzive e këtyre shteteve, të cilat kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që ato i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë

Përfundime

Projektligji “*Për buxhetin e vitit 2023*” nuk përfron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së, por rregullon çështje të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së nuk është i harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

Komisioni miratoi **në parim** me shumicë votash projektligjin në shqyrtim.

Relatore

ETILDA GJONAJ

KRYETARE

JORIDA TABAKU